

Plani dhe programi i lëndës: FILOZOFI

Klasa XI

2 orë në javë, 74 orë në vit

HYRJE

Lënda e filozofisë përfshihet në programin e klasës XI me qëllim të përgaditjes së nxënësve për jetë, përbushjes së interesave dhe potencialeve të tyre në zhvillimin e kulturës dhe në krijimin e bazës së koncepteve dhe njohurive për arritjen e qëllimeve individuale, që shpiejnë në drejtim të progresit të përgjithshëm shoqëror.

Të rinjtë kanë nevojë për një filozofi jete e cila do t'i aftësojë për të jetuar dhe për të vepruar, duke pasur projekte dhe duke qenë të angazhuar në realizimin e tyre. Pikërisht një filozofi të tillë, e cila do të ndihmonte që të kuptohet dhe të jetohet jeta, u ofrohet nxënësëve të shkollave të mesme. Ajo është njëkohësisht një koncept orientues i qëndrimit të njeriut si qenie sociale, i veprimtarisë së tij praktike e teorike, i sjelljes, por edhe orientues i idealeve të tij shoqërore.

Mendimi filozofik është zhvilluar përmes problemeve filozofike, prandaj mënyra më e natyrshme e paraqitjes së filozofisë për nxënësit është duke e përcjellur rrugën e të filozofuarit vetë.

Në këtë perspektivë, programi paraqet një grup problemesh, një seri mendimesh, duke u nisur nga përvoja e përditshme e nxënësve drejt refleksionit të vërtetë filozofik. Synimi i programit është formimi i mendimit kritik filozofik të nxënësve, duke u nisur nga ndërlidhja e dy elementeve kryesore: ofrimit të informatave mbi nocionet dhe problemet kryesore të filozofisë (nëpërmjet të teksteve të shkurta nga veprat e filozofëve) dhe mësimi aktiv (të bazuar në reflektimet) i cili njëkohësisht paraqet një nga sfidat kryesore të procesit mësimor.

Poashtu, programi do të ndikojë në nxitjen e raportit krijues të nxënësëve ndaj botës dhe vetëvetes.

QËLLIMET

Duke pasur parasysh se në klasën XI nxënësit për herë të parë merren me problematikën e gjërë filozofike, qëllimi i programit mësimor i lëndës së filozofisë është:

1. Zhvillimi i aftësive të nxënësi për të menduar në mënyrë kritike dhe analitike mbi botën dhe vetëveten, duke u bazuar në njohjen dhe kuptimin e nocioneve themelore filozofike.
2. Zhvillimi i shkathtësive të përhershme të nxënësit për t'i shprehur qartë nocionet dhe kategoritë filozofike dhe të përgjithshme, në të folurit ose në të shkruar.
3. Nxitja e raporteve krijuese ndaj vetëvetës dhe shoqërisë të nxënësi, duke u bazuar në reflektimin dhe aplikimin e njohurive të përfituara nga lëmia e filozofisë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Në përputhje me qëllimet e programit për lëndën e filozofisë së klasës së XI, objektivat e lëndës janë të orientuara në përfitimet e rëndësishme duke pasur parasysh gjithmonë nevojat për zhvillimin e nxënësit. Programi mësimor i lëndës së filozofisë synon që në fund të kursit njëvjeçar nxënësi t'i arrijë këto objektiva të grupuar sipas qëllimeve:

1. Për të arritur qëllimin e përfitimit të njohurive dhe zbatimit të tyre nxënësi do të:

- kuptojë pozitën dhe rolin e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor, dhe pasurimin reciprok konceptual të filozofisë dhe të shkencave të tjera
- njohë evoluimin e mendimit filozofik duke u ndalur në probleme më themelore të praktikës dhe qëllimeve njerëzore
- dijë të bëjë dallimin në mes të metodave kryesore të interpretimit të historisë së filozofisë
- zbërthejë nocionet dhe kategoritë kryesore të mendimit filozofik, si përgjithsime të përvojës njerëzore
- jetë i aftë për t'i pranuar mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve, duke aplikuar vazhdimisht më shumë se një këndvështrim dhe pikënisje.

2. Për të arritur qëllimin e përfitimit të aftësive dhe shkathtësive nxënësi do të:

- dijë ta strukturojë mendimin për të argumentuar qëndrimet e veta mbi çështjet filozofike dhe praktike
- hartojë punime të pavarura duke integruar informacionin teorik (nga tekste filozofike) dhe praktik.

3. Për të arritur qëllimin e zhvillimit të qëndrimeve dhe vlerave nxënësi do të:

- analizojë dhe të shpjegojë fenomene dhe procese shoqërore duke u nisur nga pikëpamjet e përgjithshme filozofike
- vështrojë realitetin në burimin e vet, si bazë për komunikim me të tjerët
- shpjegojë pozitën e vet individuale si pjesë e tërë të qenit të botës.

OBJEKTIVAT E VEÇANTA

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **të njohë**
 - vendin dhe pozitën e filozofisë në zhvillimin e përgjithshëm të menduarit njerëzor
 - metodat kryesore të interpretimit të filozofisë gjatë historisë së saj dhe të bëjë dallimet midis disiplinave kryesore të filozofisë
 - aspektet e ndryshme, të veçanta filozofike në studimin e nocionit të njeriut dhe pozitës së tij në botë
 - njohjen njerëzore në procesin e zhvillimit të saj brenda teorive të ndryshme filozofike
 - themelin e metafizikës dhe bazamentin e kritikës ndaj saj
 - problematikën e vlerave në filozofinë e moralit

- **të kuptojë**
 - nocionet themelore të estetikës në teori dhe praktikë
 - teoritë kryesore filozofike mbi shoqërinë, shtetin dhe pushtetin

- **të shprehë**
 - mendimin kritik ndaj realitetit duke u bazuar në njohuritë e fituara nga lënda e filozofisë

- **të hartojë**
 - punime të pavarura duke u bazuar në tekste burimore filozofike dhe përvojën e tij individuale

Gjimnazi – Shkenca e natyrës

Struktura e përmbajtjeve programore

Aktivitetet	Numri i orëve	%
Prezentimi i materialit tematik	47	63.5
Mësim sipas zgjedhjes	6	8.1
Përsëritje dhe vlerësimi	21	28.4
GJITHSEJ	74	100

Planifikimi i përmbajtjes programore

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	%
Filozofia dhe historia e saj	Pozita e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor dhe raporti i filozofisë me shkencat tjera	5	7.4
	Metodat kryesore në interpretimin e historisë së filozofisë		
Njeriu dhe bota	Nocioni i njeriut	16	23.5
	Pozita e njeriut në botë		
	Njeriu, koha dhe hapësira		
	Njeriu dhe historia		
Njohja dhe arsyeja	Mundësitë ndhe kufijtë e njohjes	11	16.1
	Pragmatizmi dhe veprimtaria e njohjes		
	Aftësia e të gjykuarit		
	Filozofia analitike		
Filozofia dhe metafizika	Themeli dhe kritika e metafizikës	12	17.6
	Çështja e zotit brenda metafizikës		
Etika	Morali dhe vullneti i lirë	9	13.3
	Problemi i vlerave		
Estetika	Kategoritë themelore të estetikës	6	8.8
Filozofia politike	Njeriu dhe shoqëria	9	13.3
	Shteti dhe pushteti		

PËRMBAJTJA LËNDORE

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritura	Ndërlidhjet programore
I Filozofia dhe historia e saj	1. Pozita e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor dhe raporti i filozofisë me shkenca të tjera	<p><i>Nxënësi mëson për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Çka është filozofia? • Disiplinat dhe nëndisiplinat kryesore të filozofisë • Raporti i filozofisë me shkencat e tjera • Filozofia, miti dhe religjioni <p>(3 orë)</p>	<p><i>Nxënësi do të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë termin dhe zanafilen e filozofisë • Identifikojë çështjet dhe disiplinat themelore të filozofisë • Diskutojë mbi zhvillimin e filozofisë dhe raportin e saj me shkencat e tjera • Identifikojë elemente të përbashkëta dhe dallime në mes të filozofisë, mitit dhe religjionit 	Shkencat shoqërore dhe natyrore
	2. Metodatat kryesore në interpretimin e historisë së filozofisë	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i filozofisë dhe historisë së saj është i veçantë • Metoda historike (kronologjike) dhe metoda problemore të paraqitjes së historisë së filozofisë <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojë pozitën e filozofisë në raport me historinë e saj • Kuptojë dallimin në mes të dy metodave kryesore të paraqitjes së filozofisë dhe të historisë së saj 	
II Njeriu dhe bota	1. Nocioni i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Çështjet themelore të pyetjes çka është njeriu • Përcaktimi i njeriut përmes së frymës • Njeriu si qenie kulturore <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë njeriun si qenie shumëdimensionale (ontologjike, gnoseologjike, etike, estetike, historike etj.) • Shpjegojë se si kuptohet njeriu në antropologjinë e Shellerit 	Historia, Linguistika

			<ul style="list-style-type: none"> • Analizojë elemente të gjuhës, mitit, religjionit, historisë dhe shkencës si përcaktues së nocionit të njeriut në filozofinë e Kasirerit 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Nocioni i ekzistencës • Ekzistenca në raport me esencën, mendimin dhe lirinë (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionin e ekzistencës • Diskutojë mbi vendin prioritar të esences dhe ekzistencës • Shpjegojë ekzistencën si pikënisjen e mendimit në filozofinë e Kirkegardit • Identifikojë raportin ekzistenca – liria në filozofinë ekzistencialiste 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Tjetri dhe nevoja për tjetrin (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë nocionin e tjetrit dhe nevojën për tjetrin në filozofinë e shekullit XX 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjja, njohja, dhe përvoja • Aspekti psikologjik i ndërgjegjës • Nocioni i të pandërgjegjshmes në teorinë e Frojdit (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë raportin në mes të ndërgjegjes, njohjes dhe përvojës • Kuptojë ndërgjegjen si të vërtetën e unit në filozofinë e Bergsonit • Përcaktiojë ndërgjegjen nga aspekti psikologjik • Përcaktojë pozitën e terorisë së Frojdit brenda mendimit filozofik • Analizojë të pandërgjegjshmen në teorinë e Frojdit • Shpjegojë nocionin dhe sistemin e të pandërgjegjshmes 	Psikologjia

		<ul style="list-style-type: none"> • Vdekja, kuptimi dhe mohimi i saj • Njeriu në situatat kufitare: ballafaqimi me fundin e ekzistencës <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë nocionin e vdekjes në të kuptuarit filozofik • Analizojë nocionin e vdekjes në filozofinë e Lukrecit • Kuptojë vdekjen si ballafaqim i individit me fundin e ekzistencës (K.Jaspers) 	Biologjia
II Njeriu dhe bota	2. Pozita e njeriut në botë	<ul style="list-style-type: none"> • Idea e kozmosit në filozofinë greke • Mikrokozmos dhe makrokozmos në Renesansë dhe Iluminizëm <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë kuptimin e kozmosit në filozofinë e Talesit, Anaksimandrit dhe Empedoklit • Kuptojë idean e mikro dhe makro kozmosit në filozofinë e G.Brunos, Didrosë dhe Bufonit 	Biologjia, Fizika, Astronomia
II Njeriu dhe bota	3. Njeriu, koha dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> • Koha si dimension i shpirtit • Koha dhe hapësira si formë apriori e subjektit • Relativiteti i kohës • Hapësira, zbrazëtira (boshllëku) dhe zoti <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionin e kohës në filozofinë e Shën Augustinit • Shpjegojë kohën dhe hapësirën si format subjektive të paraqitjes në teorinë e njohjes së Kantit • Shpjegojë kohën sipas Ajnshtajnit • Kuptojë pikëpamje të kundërta mbi ekzistimin e hapësirës së zbrazët (pikëpamjet atomiste, epikuriste dhe pikëpamjet e Gj. Brunos) 	Fizika

II Njeriu dhe bota	4. Njeriu dhe historia e tij	<ul style="list-style-type: none"> • Vetëprodhimi njerëzor në histori: historiciteti dhe lineariteti historik • Njeriu si qenie praktike (2 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë rolin e njeriut në prodhimin e historisë dhe vetëvetës • Kuptojë nocionin e praktikës • Identifikojë njeriun si qenie praktike në filozofinë moderne 	Historia
III Njohja dhe arsyeja	1. Njohja dhe kufijtë e saj	<ul style="list-style-type: none"> • Dyshimi si pikënisje e njohjes • Njohja mbi botën dhe njohja mbi vetëveten • Arsyeja dhe vullneti (2 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Definojë dyshimin në filozofinë e skepticizmit dhe në filozofinë racionaliste të Dekartit • Kuptojë dallimin në mes të vetëdijes dhe vetëvetëdijes • Klasifikojë përmbajtjen e intelektit: ndarjen e arsyes nga vullneti 	
III Njohja dhe arsyeja		<ul style="list-style-type: none"> • Përvoja dhe kufijtë e njohjes • Njohja fillon me përvojën, por nuk buron nga ajo • Verifikimi teorik i përvojës dhe verifikimi praktik i hipotezës (3 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë njohjen në filozofinë empiriste • Kuptojë përvojën duke u nisur nga aspekti filozofik në shpjegimin e perceptimit dhe ndijimit • Kuptojë njohjen apriori në teorinë e njohjes së Kantit • Diskutojë mbi verifikimin praktik të hipotezave (shembulli i astronomisë dhe të ngjajshme) 	

<p>III Njohja dhe arsyeja</p>	<p>2. Pragmatizmi dhe veprimtaria e njohjes</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Teoria pragmatike si teori mbi kuptimin dhe pragmatizmi si metodë • Roli i vullnetit në filozofinë pragmatike <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojë vendin e pragmatizmit në filozofinë bashkëkohore • Krijojë lidhje në mes të pragmatizmit si metodë dhe pragmatizmit si teori mbi kuptimin, në filozofinë e Ç. Persit • Përcaktojë statusin e vullnetit në filozofinë pragmatike të Xh. Uilliamsit 	
<p>III Njohja dhe arsyeja</p>	<p>3. Aftësia e të gjykuarit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykimi në logjikën formale të Aristotelit • Gjykimi si mardhënie, zgjedhje, sanksion • Të mendosh do të thotë të gjykosh <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë gjykimin në logjikën e Aristotelit • Shpjegojë gjykimin sipas Dekartit • Kuptojë gjykimin në teorinë e Kantit 	<p>Logjika</p>
<p>III Njohja dhe arsyeja</p>	<p>4. Filozofia analitike</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Çka është filozofia analitike? • E vërteta logjiko-matematike <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë parimet themelore të filozofisë analitike • Krahasojë metodën aksiomatike me metodën deduktive • Shpjegojë kuptimin e të së vërtetës logjiko-matematike në filozofinë analitike të Vitgenshtajnit 	<p>Logjika, Matematika</p>

IV Filozofia dhe metafizika	1. Themeli dhe kritika e metafizikës	<ul style="list-style-type: none"> • A është metafizika shkencë? (Nocioni i metafizikes, themeli dhe kritika e saj) • Përcaktimet e qenies nga Aristoteli deri te Hajdegeri (6 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njohë nocionin e metafizikës, themelin dhe kritikën ndaj saj • Diskutojë mbi çështjet metafizike • Shpjegojë “filozofinë e parë” në filozofinë e Aristotelit • Kuptojë përkufizimin e nocionit të qenies në teoritë filozofike nga Aristoteli deri te Hajdegeri 	
IV Filozofia dhe metafizika	2. Çështja e zotit brenda metafizikës	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmia e ekzistencës së zotit e bazuar në përvojë dhe arsye • Refuzimi i fejtës • Besimi i përbashkët • A ekziston jeta pas vdekjes? (6 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë se si provohet ekzistenca e zotit nga përvoja në filozofinë e T. Akunit • Diskutojë mbi qëndrueshmërinë e argumentimit ontologjik mbi ekzistencën e zotit të Dekarti • Shpjegojë fenë si sëmundje të qytetërimit në teorinë e Niçes • Kuptojë tentimit për një besim të përbashkët të Xh. Djuitt • Diskutojë mbi jetën pas vdekjes në fragmente të Platonit, Hjumit dhe Kirkegardit 	Sociologjia, Historia

V Etika	1. Morali dhe vullneti i lirë	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e etikës në natyrën njerëzore • Ligji i moralit: imperativi hipotetik dhe kategorik • A është vullneti i lirë? (teoritë deterministe dhe indeterministe) • Utilitarizmi në filozofinë e moralit (5 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Definojë virtytin në etikën e Aristotelit • Shpjegojë ligjin e moralit dhe detyrimin për të qenë i moralshëm në filozofinë e Kantit • Diskutojë mbi lirinë e vullnetit • Diskutojë rreth pikëpamjes ekzistencialiste mbi lirinë • Kuptojë matësin utilitar në filozofinë e Xh.S. Millit 	Sociologjia, Edukata qytetare
V Etika	2. Problemi i vlerave	<ul style="list-style-type: none"> • Çka janë vlerat në kuptimin filozofik? • Rivlerësimi i të gjitha vlerave (4 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutojë rreth “filozofisë së jetës” në teorinë e Dilthey dhe Bergsonit • Shpjegojë zëvendësimin e parimit apolonian me parimin dionizian në imoralizmin e Niçes 	Sociologjia, Edukata qytetare
VI Estetika	1. Kategoritë themelore të estetikës	<ul style="list-style-type: none"> • E bukura në art dhe në natyrë • Krijimtaria artistike • Arti dhe realiteti (6 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionet themelore të estetikës (e bukura dhe arti) në fragmente nga Platoni dhe Kanti • Diskutojë mbi temën e gjenit në art te Kanti dhe Niçes • Paraqet mendimin e Hegelit mbi artin romantik • Kuptojë historinë e artit në teorinë e Benjaminit • 	Arti

VII Filozofia politike	1 Njeriu dhe shoqëria	<ul style="list-style-type: none"> • Baza natyrore e shoqërisë • Prejardhja e shtetit: gjendja natyrore dhe kontrata shoqërore • Detyrimi i njerëzve për të qenë të lirë (4 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë natyrën njerëzore si bazë për organizimin shoqëror në teorinë e Aristotelit • Krahasojë teoritë e Hobsit dhe Rusoit mbi prejardhjen e shtetit, duke u nisur nga shpjegimi i egoizmit dhe pronës 	Edukata qytetare, Sociologjia, Historia
IX Filozofia politike	2. Shteti dhe pushteti	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i shtetit ideal • Pushteti, të bërit dhe të diturit • Individu dhe kufinj të pushtetit shtetëror • Ndarja e etikës nga politika • Demokracia moderne në teorinë filozofike (5 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Njohë konceptin kryesor të shtetit ideal dhe bazamentin e tij në ndarjen e punës në teorinë e Platonit • Kuptojë të drejtën natyrore dhe shoqërinë civile në filozofinë politike të Lokut • Kuptojë pozitën e individit në raport me fuqinë e pushtetit në teorinë e XH.S.Millit • Analizojë cilësitë primare të sovranit në teorinë e Makiavelit dhe diskutojë mbi thënien e tij “qëllimi e arsyeton mjetin” • Kuptojë teorinë e Rusoit dhe Toknevilin mbi demokracinë 	Edukata qytetare, Sociologjia, Historia

Sqarim: 6 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit për t'i organizuar sipas kërkesave të nxënësve dhe dëshirës individuale duke mbetur në kuadër të përmbajtjeve programore.

Poashtu, nuk përjashtohet mundësia që në realizimin e disa njësive mësimore të përfshihen edhe arsimtarë të lëndëve të tjera si psh. arsimtari i fizikës për nënkategorinë *Njeriu, hapësira dhe koha*, etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Qasja problemore

Duke u mbështetur në një nga qëllimet kryesore të mësimdhënies së filozofisë, të zhvilluarit e mënyrës kritike dhe analitike të të menduarit të nxënësit, lënda e filozofisë nuk duhet të ofrojë thjeshtë përcaktimin e gatshëm, formal të nocioneve, kategorive dhe teorive. Mësimdhënia e filozofisë është gjithmonë shpjegimi, analizimi dhe ndriçimi i një nocioni, problemi apo çështjeje filozofike. Mënyra më frytdhënëse në përvehtësimin e nocioneve filozofike bazohet në përshkrimin e gjenezës së nocionit, ballafaqimin, krahasimin dhe lidhjen me nocione të tjera, duke analizuar format dhe mundësitë e përdorimit të tyre.

Ndërveprimi

Në përvehtësimin e filozofisë është shumë me rëndësi që të kërkohen dhe shprehen mendimet individuale dhe grupore, gjë që nënkupton prezentimin e mendimeve në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Përshkrimi, referimi ndaj teorive të ndryshme, përdorimi i shembujve konkretë dhe krahasimi me shembuj të tjerë janë bazamente dhe tullat kryesore për ndërtimin e mendimit të pavarur të nxënësit dhe lidhjen e pjesës teorike me aplikimin praktik të saj. Në këtë mënyrë do të arrihet edhe qëllimi i dytë i lëndës së filozofisë: ofrimi i një filozofie e cila do të ndihmonte nxënësit që ta kuptojnë dhe ta jetojnë jetën.

Për t'i ikur mundësisë që lënda e filozofisë të shndërrohet në një skolastikë të mërzitshme dhe një monolog, diskutimet mbi problemet dhe çështjet filozofike duhet të jenë pjesë e pandarë e çdo ore mësimore. Poashtu, interpretimi dhe shpjegimi i teksteve të shkurtëra filozofike, është metodë shumë efektive në krijimin e kontaktit të nxënësit me filozofët e mëdhenjë. Çdo mësim duhet të shoqërohet edhe me një fjalor shpjegues të nocioneve filozofike.

Duke u bazuar në këto metodat, nxënësi duhet të orientohet drejt një bindjeje të qëndrueshme, përmes udhëzimeve se teza e mbrojtur duhet tu përgjigjet disa kërkesave, duhet të mbështetet nga faktet, të mundësojë parashikime dhe të sugjerojë hulumtime të mëtutjeshme. Nxënësi duhet ketë mundësi për paraqitjen e qëndrimeve dhe mendimeve të pavarura edhe në formë të punimeve të hartuara, duke integruar në to informacionin teorik (nga tekste filozofike) dhe praktik.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi i lëndës së filozofisë duhet të ketë parasyshë disa momente të rëndësishme gjatë vlerësimit të nxënësit:

- Mënyrën se si nxënësi di ta strukturojë mendimin për të argumentuar qëndrimet e veta mbi çështjet e ndryshme filozofike dhe praktike
- Sa është në gjendje që të integrojë informacionin teorik dhe shkencor
- Mënyrën se si nxënësi është në gjendje t'i prezentojë materialet e përvehtësuara në mënyrë individuale dhe grupore

- Sa është nxënësi në gjendje që përmes teksteve filozofike, të nxjerra nga veprat e filozofëve të mëdhenjë, të hartojë punime të pavarura.

Vlerësohen:

- Përgjigjet me gojë
- Prezentimet
- Esetë dhe punimet e pavarura

QASJET NDËRLËNDORE

Vetë fakti se filozofia është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të përgjithshëm të mendimit njerëzor, domosdo vendosë filozofinë në një rrjetë të ndikimeve të ndërsjellta me pjesë të tjera të këtij zhvillimi. Gërshetimi i problemeve shoqërore dhe natyrore drejton filozofinë në arritjet e deritanishme brenda lëndëve të tjera të veçanta. Në anën tjetër, në çdo shkallë të zhvillimit të shkencave, një sektor i veçantë dhe i gjërë në sistemin e dijeve mbi botën i takon funksionimit të pavarur të dijeve filozofike.

Në bazë të materialit tematik i cili do të prezentohet para nxënësëve është e nevojshme ndërlidhja e lëndës së filozofisë me këto lëndë sipas kategorive në vijim:

- Filozofia dhe historia e saj: Shkencat shoqërore dhe natyrore
- Njeriu dhe bota: Psikologjia, Historia, Linguistika, Fizika, Astronomia, Biologjia
- Njohja dhe arsyeja: Logjika, Matematika
- Filozofia dhe metafizika: Sociologjia, Historia
- Etika: Sociologjia, Edukata qytetare
- Estetika: Arti
- Filozofia politike: Edukata qytetare, Sociologjia, Historia

LITERATURA

1. Filozofia (Historia & Problemet), S.E.Stumpf, Toena, Tiranë
2. Filozofia (për klasën e katërt të gjimnazit), E.Murtezai, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
3. Idetë filozofike të shekullit XX, I.Berlin, Onufri, Tiranë, 2003
4. Një hyrje tek idetë, E.Raeper & L.Smith, Dituria, Prishtinë 1999
5. Thema nr.14, Instituti i filozofisë dhe sociologjisë, Prishtinë, 1996
6. Buletini i Fakultetit Filozofik, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 2001
7. Fjalori i Filozofisë, E.Murtezai, Instituti i filozofisë dhe sociologjisë, Prishtinë, 1995